

I POL

BALKAN POLICY INSTITUTE
INSTITUTI BALLKANIK I POLITIKAVE
BALKANSKI INSTITUT POLITIKA
BALKAN POLITIKA ENSTITÛSÛ

[Konkurrenca: Korniza ligjore dhe praktika ne Kosovë krahas standardeve Evropiane]

08/06/2010
Prishtinë, Kosovë

Kjo analizë është mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për një Shoqëri të hapur.

Pregaditur nga: Erton Bega

Copyright © 2010 nga Instituti Ballkanik i Politikave-IPOL. Të gjitha te drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjese e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, apo të publikohet, në ndonjë formë apo mënyre qofte, elektronike, mekanike, kopjuar apo incizuar, pa lejen paraprake nga publikuesi. Ju lutem kontaktoni info@policyinstitute.eu apo +381 38 220 552

Publikuar nga:



Balkan Policy Institute
Str, Qamil Hoxha,
Nr.4/3 , Prishtinë, Kosovo
Tel / +381 (0)38 220 552
Cell/+377 (0) 44 941 141
+377 (0) 44 746 749
www.policyinstitute.eu

Përmbajtja

Hyrje	3
Legjislacioni në Kosovë.....	4
Legjislacioni në BE.....	4
Struktura implementuese e ligjit.....	6
Krahasimi i ligjit të Republikës së Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Europian.....	6
Analiza dhe Konkluzioni	12
Rekomandime.....	16
Referenca	16

Hyrje

Dokumenti në vijim paraqet një analizë krahasuese të legjislacionit në fushën e konkurrencës në Republikën e Kosovës dhe në Bashkimin Europian.

Qëllimi i këtij prezentimi është identifikimi i nevojave legjislative të Republikës së Kosovës për të arritur standardet e Bashkimit Europian.

Ekonomia paraqet njërin prej faktorëve kryesor të anëtarësimit të një vendi në BE. Kjo theksohet edhe në 'kriteret e Kopenhagës' ku shprehimisht nga shtetet me aspirata për t'u anëtarësuar në BE kërkohet *"ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale dhe aftësia për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda unionit"*.

Nevoja për një analizë të tillë është bazuar në gjetjet e raporti të progresit të Komisionit Europian për vitin 2009, ku përgjithësisht ekonomia e Kosovës vlerësohet e dobët dhe jo-kompetitive me presionet e tregut të BE-së.

Në kuadër të fushës së konkurrencës, Komisioni Europian në raportin e progresit vlerëson, *"Përveq pak progres në implementimin e politikave të anti-trustit, implementimi i përgjithshëm i politikave të konkurrencës është në fazë shumë të hershme"*¹.

Teknika e punës e përdorur në krahasimin e bërë paraqet analizë të dokumenteve me ç'rast legjislacioni i Kosovës është krahasuar me atë të Bashkimit Europian, përkatësisht me rregulloret e Këshillit Europian.

Duke marrë në konsideratë raportin direkt të konkurrencës me mbrojtjen e konsumatorit, janë ofruar edhe disa shembuj praktik mbi kërkesat ligjore dhe zbatueshmërinë e ligjit mbi mbrojtjen e konsumatorit.

Në vijim, janë të prezentuara referencat ligjore të trajtuara gjatë analizës duke tentuar të bëhet një krahasim në mes të legjislacionit të Komunitetit Europian dhe Republikës së Kosovës, si një ndër fushat kryesore në procesin e integritimit Europian.

¹ Raporti i Progresit 2009 për Kosovën, pika 4.1.5, fq.32, Tetor 2009, Bruksel

Legjislacioni në Kosovë

Kosova në bazë të Kushtetutës së saj, në fushën e ekonomisë është e orientuar për ekonominë e tregut të hapur ku konkurrenca afirmohet dhe mbrohet me ligj.

Neni 10 i Kushtetutës së Kosovës *“Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës².”*

Ndërkaq konkurrenca është e rregulluar me ligjin nr.2004/36 i aprovuar me 8 shtator 2004. Në nenin 1 të ligjit për konkurrencës përcaktohen qëllimet e implementimit të ligjit.

Neni 1.1. *“Qëllimi i këtij ligji është që të siguroj zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme të tregut në Kosovë duke ndaluar veprimet që e kufizojnë, shtypin ose çrregullojnë konkurrencën.”*

Neni 1.2. *“Ky ligj do të vlen për të gjitha ndërmarrjet e angazhuara në aktivitete ekonomike brenda, ose që kanë ndikim ekonomik brenda, territorit të Kosovës.”*

Legjislacioni në BE

Legjislacioni³ i Bashkimit European për rregullimin e fushave të ndryshme përbëhet kryesisht përmes **traktateve, rregulloreve dhe direktivave** të Këshillit European si dhe prej vendimeve të Komisionit European.

Rregullat dhe procedurat për vendim-marrjen në Bashkimin European janë të përcaktuara në **Traktate**. Çdo propozim për një ligj të ri duhet të bazohet në një nen të veçantë të traktatit, që paraqet edhe bazën legale për çdo nismë ligjore.

Rregulloret janë të zbatueshme drejtpërdrejt në tërë hapsirën e BE-së, po sa ato të hyjnë në fuqi, pa patur nevojë për veprime pasuese nga shtetet anëtare.

Direktivat përcaktojnë një qëllim të përbashkët për të gjitha shtetet anëtare, por u mundësojnë autoriteteve të vendeve anëtare të vendosin për metodën dhe

² Kushtetuta e Kosovës, neni 10 (fq.3), 15 qershor 2009, Prishtinë

³ Udhërrëfytyesi për Insitucionet e Bashkimit European “Si funksionon Bashkimi European”, Komunitetet Europiane Korrik 2007, faqe 9.

formën e arritjes së qëllimit. Zakonisht, vendet anëtare kanë në dispozicion një deri në dy vjet për të përmbuar një direktivë.

Gjatë hulumtimit të legjislacionit në fushën e konkurrencës janë identifikuar akte nënligjore që rregullojnë aspekte të ndryshme të konkurrencës brenda Bashkimit Europian.

Konkurrenca si lëmi e veçantë është rregulluar së pari me Traktatin e Matrihtit e më vonë është zgjeruar edhe me traktatin e Lisbonës, nenet 101, 102, 103, 104, 105, dhe 106.

Rregullorja e fundit me bazë më të gjërë që rregullon konkurrencën është rregullorja 1/2003, e miratuar më 16 dhjetor 2002. Kjo rregullore synon zbatimin e një sërë rregullash mbi konkurrencën të përcaktuara në nenin 101 dhe 102 të Traktatit të Lisbonës.

Më vonë, kjo rregullore është amendamentuar dy here:

- së pari më 26 shkurt 2004 për shfuqizimin e rregullores 3975/87, amendamentimin e rregullores 3976/87 dhe amendamentimin e rregullores 1/2003 në lidhje me transportin ajror në mes të Komunitetit dhe vendeve të treta,
- ndërkaq amendamenti i dytë është bërë më 7 prill 2004 për përcaktimin e procedurave të Komisioni në bazë të nenit 101 dhe 102 të traktatit.

Poashtu mbesin në fuqi disa rregullore dhe nene rregulloresh të miratuara vite më parë siq është:

- Rregullorja nr. 19/65 e miratuar më 2 Mars 1965,
- rregullorja nr.2821/71 e miratuar më 20 Dhjetor 1971,
- rregullorja 2473/72 e miratuar më 19 Dhjetor 1972,
- rregullorja nr 3975/87 e miratuar më 14 dhjetor 1987,
- rregullorja nr.3976/87 e miratuar më 14 dhjetor 1987.

Poashtu, në fuqi janë edhe disa rregullore të tjera që rregullojnë konkurrencën brenda Bashkimit Europian në fushën e transportit bregdetar dhe tregtinë oqeanike dhe si të tilla nuk janë relevante për gjendjen në Kosovë.

Struktura implementuese e ligjit

Duke mos trajtuar në thellësi institucionet e Bashkimit European dhe mënyrën e funksionimit të tyre, në vijim janë të paraqitura organet kryesore në Bashkimin European që janë përgjegjëse për implementimin e ligjeve në fuqi:

- Komisioni European
- Autoritetet kompetente të vendeve anëtare
- Gjykata e drejtësisë në nivel kombëtar
- Komiteti Këshillues për Praktikën e Ndaluara dhe Pozitat Zotëruese

Ndërkohë, në Kosovë, i vetmi institucion ligjor për zbatimin e ligjit për konkurrencën është **Komisioni Kosovar i Konkurrencës**, i cili temelohet dhe funksionon sipas ligjit 2004/36. Përderisa roli i gjykatës nuk është mirë i definuar në ligj.

Krahasimi i ligjit të Republikës së Kosovës me legjislacionin e Bashkimit European

5.1. Ligji nr.2004.36⁴ në raport me traktatin⁵ për funksionimin e BE-së

Neni 101, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 (fq.88) i Traktatit të Bashkimit European është përshkruar dhe adaptuar në terësi nga Kuvendi i Kosovës në ligjin përkatës (neni 3, pg 3.1, 3.2, 3.3, fq.3) dhe si i tillë është në përputhje të plotë me standardin e kërkuar për kufizimin e marrëveshjeve biznesore që kufizojnë konkurrencën.

Në anën tjetër neni 101, paragrafi 3 i Traktatit të BE-së, që trajton marrëveshjet e përjashtuara nga neni 101 (pg.1 dhe 2), në ligjin për konkurrencën nuk është adaptuar në mënyrën më adekuate pasi që nuk përcakton kriteret e kërkuara për përjashtimin e marrëveshjeve që ndalohen nga dispozitat paraprake.

⁴ Ligji për konkurrencën, miratuar më 8 shtator 2004 nga Kuvendi i Kosovës

⁵ Versioni i konsoliduar i Traktatit për funksionimin e Bashkimit European, titulli 7, kapitulli 1, seksioni 1, nenet 101-106 (Gazeta Zyrtare C 115, fq.88-91, 9 maj 2008)

Në vijim është prezentuar neni i veçantë⁶ nga traktati për funksionimin e BE-së:

“Kushtet e paragrafit 1 (neni 3 në ligjin aktual në Kosovë) mund të deklarohen të pazbatueshme në rast të:

- *ndonjë marrëveshje apo kategori marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve,*
- *ndonjë vendim apo kategori vendimesh ndërmjet shoqatave të ndërmarrjeve,*
- *ndonjë praktikë e përbashkët apo kategori praktikash të përbashkëta,*

e cila kontribon në përmirësimin e prodhimit apo shpërndarjes së të mirave ose promovon progres ekonomik dhe teknik, përderisa konsumatorëve u lejon ndarje të drejt të përfitimeve nga rezultatet dhe e cila nuk:

- *ju imponon ndërmarrjeve kufizime të përbashkëta të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave*
- *ju mundëson ndërmarrjeve të tilla të përballojnë mundësinë e konkurrencës në lidhje me përjashtimin e një pjese të konsiderueshme të produktit në fjalë”*

Në nenet 4, 5, 6 dhe 8 të ligjit mbi konkurrencën, trajtohen marrëveshje të ndryshme, të cilat përjashtohen nga zbatimi i nenit 3. Në të gjitha këto dispozita ligjore, targetohen probleme specifike të promovimit apo kufizimit eventual të konkurrencës së lirë, mirëpo në asnjërin prej neneve nuk përcaktohen qartë kriteret e përgjithshme për përjashtimin e një marrëveshje nga zbatimi i nenit 3.

Neni 4 trajton problematikën e marrëveshjeve vertikale, përkatësisht të marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjes amë dhe njërive të saj, duke lënë anash marrëveshjet horizontale që kanë peshë më të madhe në krijimin e konkurrencës jo të ndershme.

Këto dispozita si të tilla shkaktojnë paqartësi dhe krijojnë hapsirë për interpretime të ndryshme, gjë që mund të sjellë vështirësi më vonë gjatë vlerësimit të marrëveshjeve biznesore nëse ato janë në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.

Neni 102 i traktatit të BE-së, trajton problematikën e pozitës mbizotëruese që një apo disa ndërmarrje mund të kenë në kuadër të tregut të brendshëm. Në vijim kemi bërë përshkrimin e kësaj dispozite⁷ në mënyrë që analiza të jetë më e qartë:

⁶ Gazeta zyrtare C115, fq 88-89, 9 maj 2008

⁷ Gazeta zyrtare C115, fq 89, 9 maj 2008

“Çdo shpërdorim nga një apo më shumë ndërmarrje të pozitës dominuese brenda tregut të brendshëm ose në një pjesë të konsiderueshme të tij do të jetë e ndaluar dhe e papajtueshme me tregun e brendshëm për aq sa ajo mund të ndikoj në tregtinë brenda shteteve anëtare.

Shpërdorimi i tillë në veçanti mund të konsistojë:

- *në vendosjen e padrejtë të çmimeve të shitjes apo blerjes dhe kushteve tjera tregtare në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi*
- *në kufizimin e prodhimit, zhvillimit teknik, dhe tregut në dëm të konsumatorëve*
- *në zbatimin e kushteve të ndryshme në transaksione tregtare ekuivalente me palë të ndryshme duke i vendosur at one disavantazh konkurrues*
- *në përmbylljen e kontratave me qëllim pranimit e detyrimeve shtesë nga palët tjera të cilat për nga natyra apo përdorimi tregtar nuk kanë asnjë lidhje me qëllimin e kontratave të tilla”*

Ndërkaq, në ligjin për konkurrencën në Kosovë, kjo çështje është e rregulluar në pjesën IV përkatësisht nenet 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Në nenin 15, që konstaton pozitën dominuese të ndërmarrjeve, nuk përcaktohet si kriter bazë për vlerësimin e kësaj pozite vendosja e padrejthe e çmimit të blerjes ose shitjes.

Poashtu ky nen nuk merr parasysh që përmes pozitës dominuese një ndërmarrje mund të kufizojë prodhimin, teknologjinë dhe zhvillimin e tregut në përgjithësi prandaj për rrjedhojë është i papajtueshëm me standardet e BE-së.

Neni 16, që synon ndalimin e diskriminit dhe pengimin e padrejt, nuk është preciz dhe i qartë në kërkesat e tij në paragrafin 1 dhe 2. Për të ilustruar këtë paqartësi, po prezentojmë nenin 16.1⁸:

‘Një ndërmarrje dominuese, një shoqëri e ndërmarrjeve ose një ndërmarrje që i cakton çmimet me pakicë nuk e pengon drejtpërsedrejt apo tërthorazi një ndërmarrje tjetër në aktivitetet e saja afariste, ose drejtpërsedrejt apo tërthorazi të trajtojë atë ndryshe nga ndërmarrjet e tjera të ngjashme, përveç nëse ekziston arsyeimi objektiv për trajtimin e tillë.

⁸ Ligji për Konkurrencën, nr 2004/36 (fq.10), Kuvendi i Kosovës, 8 shtator 2004

Në këtë rast nuk është definuar saktë dhe qartë nëse një praktikë e tillë është e ndaluar apo e lejuar ndonëse nga emërtimi i këtij kreu të ligjit kuptohet që bëhet fjalë për praktika kufizuese. Si rrjedhojë, ne mund ta interpretojmë këtë nen në mënyra diametralisht të kundërta, përkatësisht nëse caktimi i çmimeve me pakicë është i lejuar dhe nuk i kufizon ndërmarrjet tjera apo një gjë e tillë është e ndaluar me këtë dispozitë.

Edhe në këtë pjesë të ligjit, kriteret për vlerësimin e shpërdorimit të pozitës dominuese në treg janë të paqarta dhe të padefinuara mirë. Prandaj përkitazi për këtë kemi përgatitur rekomandimin e tretë.

5.2.Ligji 2004/36 në raport me rregulloren e Këshillit BEE 19/65⁹

Në pjesën e tretë të ligjit për konkurrencën sipas emërimit trajtohen marrëveshjet vertikale. Së pari, në nenin 2 mungon përkufizimi për marrëveshjet vertikale dhe kjo nuk është shpjeguar poashtu në pjesën e tretë.

Marrëveshjet vertikale sipas emërimit janë marrëveshje ndërmjet ndërmarrjes amë dhe njësive të saj, apo marrëveshje për të drejta ekskluzive të blerjes, shitjes apo rishitjes të produkteve apo shërbimeve të caktuara.

Duke u nisur nga ky përkufizim rezulton që neni 10 është në kundërshtim me nenin 4 të ligjit 2004/36.

Në anën tjetër neni 11 i këtij ligji, që trajton shpërdorimin e transaksioneve ekskluzive tregtare është në kundërshtim të plotë me rregulloren e BE-së (më parë BEE) nr 19/65, neni 1, pasi që kufizon ekskluzivitetin e shitjes dhe rishitjes që mund të arrihet nga dy palë përmes një marrëveshje biznesore.

5.3.Ligji 2004/36 në raport me rregulloren e Këshillit EC 1/2003¹⁰

Duke krahasuar pjesën e pestë, kreun e dy të ligjit Kosovar për konkurrencën me rregulloren EC 1/2003 (kapitulli 5), gjëja e parë që tërheq vëmendjen është mungesa e nenit, i cili jep udhëzimet se kur dhe mbi çfarë baze, KKK mund të nis një hetim. Për më shumë, edhe emërtimi i kapitujve është i ndryshëm, ne

⁹ Rregullorja nr 19/65/EEC e Këshillit, 2 mars 1965 në aplikimin e nenit 85 (3) të traktatit për kategori të veçanta të marrëveshjesh dhe praktika të përbashkëta

¹⁰ Rregullorja e Këshillit (EC) nr 1/2003, 16 dhjetor 2002 për implementimin e rregullave të caktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit

rregulloren e BE-së, kjo pjesë emërtohet "Fuqitë e Hetimit"¹¹ ndërsa në ligjin në Kosovë quhet "Marrja e Informatave"¹².

Kreu i dytë i ligjit në Kosovë është i pranueshëm në raport me dispozitat tjera të rregullres 1/2003, përpos që në disa raste është më specifik se vet rregullorja.

5.4.Komisioni Kosovar i Konkurrencës

Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK) është themeluar në bazë të nenit 20 të ligjit 2004/36 dhe ka filluar të funksionoj që nga fundi i vitit 2009, respektivisht me mbi 4 vjet vonesë.

KKK-ja ka 5 anëtarë drejtues që emërohen nga Kuvendi dhe 5 anëtarë të personelit. Duke u bazuar në gjendjen faktike nga vizita jonë në këtë institucion, konstatojmë që kushtet e punës, duke përfshirë buxhetin vjetor, hapsirën dhe personelin nuk plotësojnë nevojat e këtij institucioni për zbatimin e kërkesave që dalin nga ligji mbi konkurrencën.

Ndonëse i funksionalizuar me vonesë, KKK gjatë vitit 2009 ka hetuar vetëm tri raste¹³:

1. rastin e marrëveshjes së furrëtarëve për çmimin e bukës,
2. marrëveshjen mbi themelimin e POOL-it për sigurimin kufitar
3. vendimin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit për kontrollin teknik të automjeteve

Duke përshëndetur hetimet e ndërmarra nga KKK, duhet të pasqyrojmë faktin që KKK nuk ka zbatuar dispozitat ligjore nga pjesa VI, kreu 1 për ndërmarrjet që kanë vepruar në kundërshtim me ligjin. Prandaj, hetimi i ndërmarrje përpos në rastin e parë që ka përfunduar me tërheqjen vullnetare të furrëtarëve nga marrëveshje, në të dy rastet tjera është i pambaruar.

Vlen të theksohet se në rastin e dytë dhe të tretë, shkelja e ligjit nga ndërmarrjet është bërë me nismën ligjore të institucioneve publike, në rastin e dytë nga Banka Qëndrore e Kosovës dhe në rastin e tretë nga Ministria e Transportit dhe

¹¹ Rregullorja e Këshillit (EC) nr 1/2003, 16 dhjetor 2002, fq.13

¹² Ligji nr.2004/36, Kreu 2, fq.17

¹³ Raport mbi veprimtarinë e Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009 dhe objektivat për vitin 2010 (fq.15-21), Prishtinë, Shkurt 2010

Telekomunikacionit, gjë që pasqyron mangësitë dhe dobësitë juridike në të dyja këto institucione.

Sipas kompetencave ligjore, KKK mund të nis hetime në dy forma, ex-officio and in-officio. Kjo do të thotë që roli i saj nuk është vetëm të pres paraqitjen e rasteve nga palë të caktuara por poashtu të nuhas marrëveshjet dhe zhvillimet brenda tregut në Kosovë.

Përpos këtyre, me nenin 24, KKK është e obliguar që të ofroj udhëzime mbi kërkesat e ndryshme të ligjit në fjalë dhe për rrjedhojë të organizoj sipas vlerësimeve seminare dhe trajnime për edukimin grupeve të caktuara për zbatimin e ligjit. Në kë kontekst, roli i KKK-së ka qenë i varfër.

Nga gjendja aktuale është shumë e vështirë të merren informacione për legjislacionin në fushën e konkurrencës. KKK nuk ka as faqe zyrtar të internetit ku mund të merren informacione mbi aktivitetin e tij dhe legjislacionin në fuqi.

Analiza dhe Konkluzioni

Duke analizuar ligjin për konkurrencën në terësi dhe krahasuar atë me rregulloret e Bashkimit European rezulton që ligji i synon objektivat e njejta me atë të legjislacionit të Bashkimit European. Por, dispozitat ligjore për implementimin e tij janë të paqarta dhe konfuze në shumë aspekte kyçe që mbrojnë konkurrencën prandaj si i tillë është i papranueshëm për standardet e aplikuara në BE.

Duke qenë të vetëdijshëm që ekonomia paraqet një nga fushat kryesore, në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European, duke qenë edhe pjesë e kriterëve themelore për anëtarësim, që nga viti 1993, që në konkluzionet e Këshillit European në Kopenhagen, është më se e domosdoshme që në përkrahje të procesit të integrimit European, të aplikohen standardet e BE-së në legjislacionin e Kosovës.

Për më shumë, hartimi dhe implementimi i ligjeve efektike në fushën e ekonomisë sjellë dobi për tërë shoqërinë, duke i dhënë dinamizëm dhe ndershmëri aktivitetit ekonomik.

Konkurrenca, si një fenomen i ri në tregun kosovar, nuk është e zhvilluar sa duhet dhe nuk është pjesë e mirëfilltë e kulturës së biznesit nga arsye shumë të ndryshme. Mirëpo, është momenti që me anë të ligjeve moderne adekuate që i shërbejnë interesit publik, ta integrojmë edhe këtë nevojë të ekonomisë së tregut të lire e të hapur në kuadër të kulturës së të bërit biznes.

Ka shumë sektorë të ekonomisë, ku Komisioni Kosovar i Konkurrencës mund të hetojë për konstatimin e pozitës dominuese, shpërdorimin e pozitës dominuese, marrëveshje të kundërligjshme, etj.. Dhe, për t'u bërë më konkret, ne vetëm po përmendim disa:

- a) tregu i telekomunikimit
- b) tregu bankar¹⁴
- c) tregu i derivateve të naftës
- d) tregu i sigurimeve,

¹⁴ Raporti i Progresit 2009 për Kosovën, *Zhvillimi i sektorit financiar*, fq.26, Tetor 2009, Bruksel (në bazë të ligjit mbi konkurrencën, neni 14, pg 4, pesë ose më pak ndërmarrje kanë pozitë dominuese në treg nëse kanë pjesëmarrje të përbashkët pres së paku 70%, ndërkaj në raportin e progresit, pasqyrohet që nga tetë banka komerciale në Kosovë, tri prej tyre ndajnë 90% të tregut)

- e) tregu i kontrollit teknik të automjeteve,
- f) transporti publik i udhëtarëve.

Dyshimi ynë në të gjitha rastet e përmendura bazohet në rregulloren 1/2003¹⁵ të Bashkimit Europian sepse kemi bazë çmimet e ngurta ndërkaq për tregun e telekomunikimit bazohemi edhe në ligjin për konkurrencën¹⁶ duke bërë një analizë me tregjet e krahasueshme që karakterizohen me konkurrencë efektive.

Tregu i telekomunikimit në Kosovë nuk është i liberalizuar në masën e duhur, për shkak që shpenzimet në telekomunikacion, si përqindje e GDP-së, vazhdojnë të mbeten ende të larta. Kjo ishte arsyeja që shtetet e rajonit liberalizuan edhe më tej tregun duke ofruar licensë për tre e më shumë operatorë të telefonisë mobile, por edhe asaj fikse, në mënyrë që të evitonin marrëveshjet eventuale ndërmjet kompanive të të njejtit sektor industrial.

Kosova është i vetmi vend në rajon, ku në tregun e telefonisë mobile janë të licensuar dy operatorë (duke përjashtuar operatorët virtual). Çmimet e këtyre operatorëve janë pothuajse të njëjta. Dhe, jo më shumë se para pak muajve kemi patur një marrëveshje mes tyre për përcaktimin e çmimeve për disa shpërbime, siq është ri-blerja e SIM kartelës së humbur apo të dëmtuar.

Për më shumë, çmimet në tregjet në shtetet e rajonit janë më të ulëta dhe ofertat e telefonisë mobile janë më të volitshme dhe më të diversifikuara në Kosovë. Shembull tipik, është veprimi i të njejtit operator në Kosovë dhe në Maqedoni, ku për ofertën e njejtë të pakos 'post-paid', konsumatorët në Kosovë paguajnë disa herë më shumë.

Tregu bankar edhe pse me shumë akterë, sipas raportit të progresit të Komisionit Europian, vazhdon të dominohet nga tri banka që ndajnë 90% të tregut në Kosovë. Normat mujore të interesit në këto tri banka përveq që janë shumë të larta, poashtu janë shumë të përafërta duke lëvizur jo nga 0.05% deri në 0.1% në krahasim me njëra-tjetrën.

Poashtu tarifatat për mirëmbajtje të llogarive bankare vazhdojnë të mbesin të njëjta, sikurse edhe çmimet për tranfere në banka tjera nacionale dhe transferet ndërkombëtare. Ka edhe shërbime të tjera që kanë çmime të njëjta, siq janë i

¹⁵ Rregullorja e Këshillit (EC) nr 1/2003, neni 13, 16 dhjetor 2002, fq.13

¹⁶ Ligji nr.2004/36, Kreu 1, neni 15, fq.17

ashtuquajturi komision mbi kredinë në nivelin 2%, vërtetimet për nevoja të ndryshme, etj.

Tregu i derivateve të naftës vazhdon të jetë i dyshimtë në aspektin e konkurrueshmërisë. Në shikim të parë duket se kemi segmentim të tregut në përcaktimin e çmimeve sipas rajoneve. Shtrojmë pyetjet, si është e mundur që çmimet në një regjion të Kosovës të jenë të njejta, si është e mundur që lëvizjet e çmimeve të ndodhin në të njejten kohë; si përcaktimi i çmimeve? Duke patur parasysh që produktet e derivateve të naftës, përbëjnë njërin prej treguesve kryesor të shpenzimeve në konsumin e një vendi dhe për rrjedhojë edhe në zhvillimin e biznesit, është rast i cili duhej të ishte hetuar nga Komisioni Kosovar i Konkurrencës.

Tregu i sigurimeve vazhdon të ofrojë çmime të njejta për konsumatorin e Kosovës edhe pse në aspektin kuantitativ duket i liberalizuar. Si është e mundur që sigurimi i një automjeti me kubikazh të njejtë, të ketë çmim sigurimi të njejtë në të gjitha kompanitë? Edhe ky është rast për t'u hetuar.

Tregu i kontrollit teknik të automjeteve paraqet rastin konkret të ndarjes së tregut me udhëzim të institucioneve. Pse një pronar veture nga komuna e Prizrenit të mos mund të kryej kontrollin teknik të veturës së tij në Prishtinë apo e kundërta? Kosova është unike sipas kushtetutës së saj dhe kjo paraqet ndërhyrje të qeverisë në zhvillimin e tregut në këtë fushë. Edhe në këtë sektor, çmimet janë të njejta në çdo kompani. Pse duhet të jenë çmimet e njejta? Edhe këtu kërkohet hetim nga KKK.

Së fundmi, kemi rastin e vendosjes së arkave fiskale. Duke përshëndetur veprimin për vendosjen e arkave fiskale, që sipas qëllimit të tyre ndikojnë në parandalimin e evazionit fiscal e për rrjedhojë edhe inkasimin e tatimeve në mënyrë më të drejt dhe rritjen e të ardhurave të buxhetit shtetëror, ne nuk mund të mos përmendim faktin që veprimi i institucioneve respektive bie ndesh me ligjin e konkurrencës pasi që të njejtat kanë licensuar vetëm dy kompani për të bërë distribuimin e arkave fiskale duke ju dhënë atyre në mënyrë automatike pozitë dominuese në treg. Pyetjet që ngriten janë: Pse duhet të jenë vetëm dy kompani? A ekziston marrëveshje mes këtyre kompanive për përcaktimin e çmimeve?

Prandaj duke patur parasysh edhe këtë situatë të krijuar, së bashku me disa situata të përmendura më sipër, mund të konkludojmë që performance e

institucioneve të Kosovës në krijimin e një tregu konkurrues nuk ka qenë e dobishme. Në shumë raste ato nuk kanë vepruar në zbatimin e ligjit e konkurrencës. Për më tepër, përmes vendimeve të tyre kanë ndikuar në përcaktimin e çmimeve dhe ndarjen e tregut.

Si rezultat i kësaj gjendje, konsumatori në Kosovë paguan çmime të larta të telefonisë fikse, mobile dhe internetit, paguan norma interesi më të shtrenjta për hua të marrur dhe fiton norma më të ulëta interesi në kursime, dhe paguan më shtrenjtë se të tjerët derivatet e naftës.

E tërë kjo situatë është rrjedhojë e mungesës së legjislacionit adekuat, moszbatimit të ligjeve ekzistuese, dhe mos-ndërtimit dhe mos-përkrahjes së strukturave për implementimin e ligjeve. Këtu ka dyshime për kolizion mes institucioneve dhe kompanive që përfitojnë nga pozitat dominuese në treg. Dhe përgjithësisht vërehet mungesa e vullnetit politik për të përmirësuar konkurrencën në treg.

Prandaj, ne kemi përgatitur disa rekomandime që do të përmirësonin mbrojtjen e konkurrencës në Kosovë.

Rekomandime

1. Ndryshimi i ligjit për konkurrencën dhe përshtatja e tij me traktatin dhe rregulloret në fuqi të Bashkimit European.
2. Ngritja e kapaciteteve të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, duke përfshirë ngritjen kuantitative dhe kualitative të personelit, sidomos në fushën juridike, zgjerimi i kushteve të punës dhe ngritja e buxhetit për aktivitete operative.
3. Ngritja e faqes së internetit të KKK-së që do të ju mundësonte të interesuarve marrjen e informacioneve të ndryshme për konkurrencën, dhe do të griste transparencën e punës së vet komisionit.
4. Ndërmarrjen e fushatave edukative për zbatimin e ligjeve që mbrojnë konkurrencën duke përfshirë fushata mediale, seminare, trajnime, udhëzues, etj.
5. Ngritjen e hetimeve ex-officio nga KKK për t'i hetuar sektorët strategjik të ekonomisë ku çmimet janë të ngurta dhe të njejta nga pothuajse të gjitha kompanitë.

Referenca

- Raporti i Progresit për Kosovën 2009, Komisioni European, Tetor 2009, Bruksel
- Udhërrëfyesi për Insitucionet e Bashkimit European “Si funksionon Bashkimi European”, Komunitetet Europiane, Korrik 2007
- Kushtetuta e Kosovës
- Ligji për konkurrencën, miratuar më 8 shtator 2004 nga Kuvendi i Kosovës
- Versioni i konsoliduar i Traktatit për funksionimin e Bashkimit European, titulli 7, kapitulli 1, seksioni 1, nenet 101-106 (Gazeta Zyrtare C 115, fq.88-91, 9 maj 2008)

- Rregullorja nr 19/65/EEC e Këshillit, 2 mars 1965 në aplikimin e nenit 85 (3) të traktatit për kategori të veçanta të marrëveshjes dhe praktika të përbashkëta
- Rregullorja e Këshillit (EC) nr 1/2003, 16 dhjetor 2002 për implementimin e rregullave të caktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit
- Raport mbi veprimtarinë e Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009 dhe objektivat për vitin 2010, Prishtinë, Shkurt 2010
- Çmimoret e kompanive të analizuar

Rreth Nesh

Instituti Ballkanik i Politikave është një institut i pavarur dhe jo-fitimprurës që synon të inicojë dhe thellojë debatin rreth politikave publike në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Me seli në Prishtinë, Kosovë, Instituti Ballkanik i Politikave punon për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë nëpërmjet bërjes së politikave pragmatike që punojnë për të mirën e qytetarëve.

Misioni ynë është forcimi i kuptimit të politikave publike duke ditur rëndësinë që kanë ato në mesin e qytetarëve të Kosovës, shoqërisë civile grupeve avokuese dhe institucioneve vendimmarrëse. Ne e bëjmë këtë duke identifikuar çështjet më kryesore, duke bërë hulumtime, duke gjeneruar zgjidhje inovative dhe strategjike që kanë për qëllim të kuptuarit e problemeve të shoqërisë dhe politikave publike.

Instituti Ballkanik i Politikave – IPOL ka për qëllim që të ofroj analiza të shëndosha dhe profesionale për vendimmarrësit; të ofroj metoda efektive për avokim për qytetarët dhe grupet e interesit duke i mbështetur ata në procesin e vendimmarrjes. Objektivat e Institutit Ballkanik për Politika janë: Sigurimi i procesit për integritet evropian, decentralizmi dhe reformat e tregut që të jenë shfrytëzuar për forcimin e vendimmarrjes së qytetarëve; për ti fuqizuar komunitetet lokale për adresimin e sfidave të tyre në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme; ngritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë dhe sigurimi i një ambiente më të shëndetshme të mirëqenies.

Instituti Ballkanik i Politikave bashkëpunon ngushtë me partner të shoqërisë civile, qeverisë dhe akademik duke i shfrytëzuar një qasje drejt arritjes së qëllimeve të saj; në mënyrë pro-aktive angazhohet me akteret kyç të hartuesve të politikave publike, në vazhdimësi zhvillojnë studime duke ofruar përgjigje të përshtatshme për çështje me rëndësi, bënë monitorimin e zbatimit të politikave publike duke analizuar edhe pasojat që krijojnë ato.

Fokusi i Institutit Ballkanik të Politikave përfshinë punën e qeverisë, zhvillimin e qëndrueshëm, çështjet sociale, shëndetësia, arsimit, zhvillimi ekonomik, qeverisja lokale, marrëdhëniet rajonale dhe ndërkombëtare, sundimin e ligjit, transparenca dhe shoqëria civile.

Instituti Ballkanik i Politikave punëson staf të përhershëm dhe kërkon ekspertë të fushave të ndryshme si dhe praktikantë. Stafit të Institutit dhe ekspertët janë individë të motivuar dhe dinamikë të përkushtuar për Kosovën dhe rajonin e Evropës juglindore.

Balkan Policy Institute

Str, Qamil Hoxha

Nr.4/3 , Prishtinë, Kosovo

Tel / +381 (0)38 220 552

www.policyinstitute.eu